

Bardha Mançe

VARGJE PLOT TALLAZE DASHURIE DHE DHIMBJEJE

Në vëllimin e gjashtë me poezi, poeti dhe shkrimtarit i mirënjohur, Besim Xhelili, na vjen tanimë mjaft i pasur me përvoja dhe ndjenja të një shpirti tepër të trazuar, që të tensionon dhe të nxit të kërkosh në thellësi të tij, duke jetuar së bashku me të tallaze të forta të një dashurie që okupon çdo qelizë të protagonistit. Me një lehtësi të mahnitshme në përdorimin e fjalëve, vargjeve e figurave poetike autori operon natyrshëm për të nxjerrë në pah një botë të tërë shpirtërore të cilën e zbërthen në detaje nëpërmjet meditimeve lëvizëse të cilat vrapojnë duke u ngutur të arrijnë sa më shpejt në idenë, që bukuria e jetës qëndron në atë përkushtim të hyjnizuar të qenies që ka okupuar çdo segment të unit të protagonistit, i cili na shfaqet gjithnjë në vetën e parë. Ky detaj të shprehuri i jep autorit liri të sillet me fjalën e ëmbël apo të hidhur, të lehtë apo të rëndë, me aq dashuri dhe muzikalitet që përfundon në një gjetje të këndshme rime dhe aty-këtu ta ndjejë veten edhe ai, si protagonist të ngjarjeve që rrjedhin aq natyrshëm. Të 183 lirikat janë pjesë të unit në të gjithë elementët e koshiençës dhe subkoshiençës që autori na i bën lehtësisht të kuptueshme me gjetjet e shumta figurative, ku shpjegon si dhe pse ndjehet në një mënyrë të caktuar.

51

*E dija se sytë e tu kanë lidhje me yjet
Prej se ato s'më durojnë e as më shohin,
Vajtojnë zogjtë, natyra, qielli dhe pyjet
Dhe s'ka rreze që ndjenjat e mia i ngrohin...*

53

*Më thuaj, pse më quan të pandershëm
Aq pastër si loti i parë i fëmijës të dua,
Kam një respekt t'fortë e t'pashterrshëm
A mund të jem i dëmshëm për ty, thua?!*

Herë mistik dhe i pakapshëm, herë nostalgjik dhe i mbytur në të shkuarën, ai kërkon të dalë në zgjidhje ekstreme në raportin jetë – vdekje, që përshkon shumë momente të poezisë së tij në mënyrë fatale. E dashura e protagonistit identifikohet me frymimin e jetës së tij, gjakun në deje, çdo lëvizje të zemrës dhe të trurit të tij. Ajo e nguroso apo e gjallëron, e vdes apo e ngjall, i jep dritë apo e lë në terr, i sjell tallaze kënaqësie apo stuhi të fuqishme dhimbjeje.

Është vetvetja, qendra e gjithësisë është gjithçka. Ka kaq shumë dhimbje në këtë dashuri saqë shfaqëson lotët e herëpashershëm të autorit.

73

*Herë-herë qaj vetëm përbrenda, në fshehtësi
Lirohem dhe për ca çaste ndjem i pushuar,
Sa kthjellohem, ti m'vjen shkurt vjedhurazi
Dhe si gjithherë ikë, zemrën ma lë të lënduar.*

127

*Ja moj mike, një yll u shkëput nga qielli dhe ra,
Mua zemra menjëherë diçka më dëshiroi,
Por, si çdo natë, sa hapa sytë i gjori çka me pa
Një lot i flakshëm faqet m'i dogji e përvëloi...*

Herë të tjera, si i zgjuar nga një gjumë letargjik autori mundohet të kapet pas realitetit, ta mbajë atë, por subkoshienca nuk e lejon të rrijë gjatë aty (poezitë 4, 34, 37). Autori e do dritën, e kërkon, por e gjen veçse të ngrënë nga retë (poezia 58). E kërkon dritën në sytë e asaj që adhuron sa asgjë tjetër në botë (poezia 51). I kthehet dëshirës dhe besimit (poezia 44). Një dashuri e plotë, shoqëruar me flakë te mëdha, shumë herë duket e njëanshme dhe fatale, por që autori gjithnjë i sillet në mënyrë më shumë se fisnike, duke qenë tepër i kujdesshëm që në asnjë rast të mos lëndojë apo pikëllojë atë që e lë rob kohe duke pritur (poezia 72). Një botë fisnike zbulohet para nesh që nuk lë hapësirë për ta mëshiruar protagonistin, por të thith të jetosh me dhimbjen, mbytjen, orgjinë, çlirimin dhe zgjimin e tij! Shumë suksese të mëtutjeshme autorit!

Athinë, Greqi
Maj 2016